

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëritë ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, dorëzuar përmes avokatit Bozhidar Milosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 21.08.2024, miratoi këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni do të fitojë kontrollin mbi SUPERNOVA ÇAZMA sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën Avenija Veçeslava Holjevca 62, Zagreb, Republika e Kroacisë dhe SN DUBICA sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën Avenija Veçeslava Holjevca 62, Zagreb, si dhe kontrollin indirekt mbi shoqëritë: Çazma energija sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën Novaçiq Milana 7, Qyteti Çazma, Republika e Kroacisë dhe Dubica energija sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën Novaçiq Milana 7, Qyteti Çazma, Republika e Kroacisë, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 22.07.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) ka pranuar një njoftim për përqendrim nga shoqëritë ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, me të cilin ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k. do të fitojë kontrollin mbi SUPERNOVA ÇAZMA sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën Avenija Veçeslava Holjevca 62, Zagreb, Republika e Kroacisë dhe SN DUBICA sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën Avenija Veçeslava Holjevca 62, Zagreb, si

dhe kontrollin indirekt mbi shoqëritë: Çazma energija sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën Novaçiqja Milana 7, Qyteti Çazma, Republika e Kroacisë dhe Dubica energija sh.p.k. me seli të regjistruar në adresën Novaçiqja Milana 7, Qyteti Çazma, Republika e Kroacisë, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k. është një shoqëri sllovene për menaxhimin e fondeve alternative të investimeve, e themeluar në fund të vitit 2020, me veprimtari kryesore të regjistruar - menaxhimi i fondeve. ALFI Renuabls menaxhon fondin e specializuar të investimeve ALFI burimet e gjelbra të energjisë, Fond i Specializuar i Investimeve, me seli të regjistruar në adresën rruga Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, i cili kryen aktivitetin e investimit të fondeve të mbledhura nga investitorë të ndryshëm sipas politikës së tij të investimit, në termocentralet e erës dhe fotovoltaike që prodhojnë energji elektrike përmes transformimit të energjisë së erës dhe diellit si burime të rinovueshme natyrore, mundësisht në fazën e ndërtimit ose në fazën e mëvonshme të zhvillimit. Fokusi primar i investimit të ALFI burimet e gjelbra të energjisë është Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.

Portofoli i shoqërive që në kuptimin më të gjerë përfshin ALFI Renuabls dhe ALFI Grin Enerxhi Fond, si dhe shoqëritë e tyre të lidhura, në tekstin e mëtejshëm do të referohet si: "Grupi Alfi".

Grupi Alfi është aktiv kryesisht në menaxhimin e investimeve dhe pasurive, veçanërisht në fushat e shitjes me pakicë, mbledhjes së borxheve dhe investimeve të tjera alternative. Grupi Alfi kryen analiza të investimeve potenciale dhe menaxhon fondet e investimeve, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve pjesërisht u është besuar shoqërive të tjera në grup.

Në përbërjen e tij më të gjerë, Grupi Alfi ka shoqërinë e varur të mëposhtme të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

Shoqëria për tregti dhe shërbime APOLLO MK SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në adresën Bulevardi Kiro Gligorov nr. 13, Gazi Babë, Shkup, me veprimtari prioritare të regjistruar - tregtia me shumicë e produkteve të tjera. Shoqëria është aktive në shitjen me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesoreve për fëmijë dhe produkteve tekstile për fëmijë.

-SUPERNOVA ÇAZMA sh.p.k. është një shoqëri me qëllim të veçantë, e themeluar më 3 tetor 2023 në Republikën e Kroacisë, me veprimtari prioritare të regjistruar - prodhimi i energjisë elektrike.

Si kusht për blerjen nga parashtruesi - ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k. të 100% të aksioneve në shoqërinë e synuar - SUPERNOVA ÇAZMA sh.p.k., SUPERNOVA ÇAZMA sh.p.k. menjëherë para zbatimit të transaksionit të propozuar do të fitojë 100% të pjesëve në shoqërinë Çazma energija nga aksionari aktual dhe i vetëm i shoqërisë

Çazma energija - z. Tomislav Kitoniq, shtetas i Republikës së Kroacisë, me vendbanim në Bojana 2, 43240 Bojana, Republika e Kroacisë.

Shoqëria Çazma energija është themeluar më 24 mars 2023 dhe ka zhvilluar projektin për centralin fotovoltaik "Çazma" në qarkun Bjelovar-Bilogora, Republika e Kroacisë, me kapacitet të projektuar për lidhje prej 90 MW. Çazma energija zotëron prona, leje dhe të drejta të caktuara për zhvillimin dhe ndërtimin e centralit fotovoltaik "Çazma".

Shoqëria SUPERNOVA ÇAZMA sh.p.k. (duke përfshirë shoqërinë Çazma energija) nuk ka shoqëri të varura të regjistruara dhe as nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

-SN DUBICA sh.p.k. është një shoqëri me qëllim të veçantë e themeluar më 3 tetor 2023 në Republikën e Kroacisë, me veprimtari prioritare të regjistruar - prodhimi i energjisë elektrike.

Si kusht për blerjen e 100% të pjesëve në shoqërinë e synuar SN DUBICA sh.p.k. nga parashtuesi - ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve alternative të investimeve, sh.p.k., SN DUBICA sh.p.k. menjëherë para zbatimit të transaksionit të propozuar do të fitojë 100% të pjesëve në shoqërinë Dubica energija nga aksionari aktual dhe i vetëm i shoqërisë Dubica energija - z. Tomislav Kitoniq, shtetas i Republikës së Kroacisë, me vendbanim në Bojana 2, 43240 Bojana, Republika e Kroacisë.

Shoqëria Dubica energija është themeluar më 15 qershor 2023 dhe ka zhvilluar projektin për centralin fotovoltaik "Dubica" në qarkun Sisak-Moslavina, Republika e Kroacisë, me kapacitet të projektuar për lidhje prej 90 MW. Dubica energija zotëron prona, leje dhe të drejta të caktuara për zhvillimin dhe ndërtimin e centralit fotovoltaik "Dubica". Megjithatë, Dubica energija ende nuk është aktive në treg, nuk ka kapacitete të instaluar dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur, por pas përfundimit të ndërtimit të centralit fotovoltaik "Dubica" do të kryejë veprimtarinë - shfrytëzimin e centralit fotovoltaik, përkatësisht prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike të marrë nga energjia diellore në Republikën e Kroacisë.

SN DUBICA sh.p.k., duke përfshirë shoqërinë Dubica energija, nuk ka shoqëri të varura të regjistruara dhe as nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска